



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

"PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM"

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18) dhe nenit 23, paragrafi 2 të Ligjit të Veprimtarisë me Valuta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15 dhe 23/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/19)

1. Në Vendimin për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët të cilët nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16), në pikën 2, pas nënpikës 2.8. shtohen katër nënpika të reja 2.9, 2.10, 2.11 dhe 2.12, si më poshtë:

"2.9 Rezidentët që shitën pasuri të paluajtshme jashtë vendit, për shlyerjen e kërkesave nga shitja e pasurisë së paluajtshme.

Fitimi i pasurisë së paluajtshme jashtë vendit vërtetohet me dëshmi të kryerjes së regjistrimit në regjistrin e investimeve në pasuri të paluajtshme në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shitja e pasurisë së paluajtshme dëshmohet me kontratë shitblerjeje.

Llogaria në bankën e huaj mbi këtë bazë mund të çelet vetëm në vendin ku është blerë pasuria e paluajtshme që është objekt i kontratës së shitblerjes dhe mund të përdoret vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë deri në lartësinë e kontratës së shitblerjes.

2.10 Rezidentët që japin me qira pasuri të paluajtshme jashtë vendit, për shlyerjen e kërkesave në bazë të dhënies me qira të pasurisë së paluajtshme.

Fitimi i pasurisë së paluajtshme jashtë vendit vërtetohet me dëshmi të kryerjes së regjistrimit në regjistrin e investimeve në pasuri të paluajtshme në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Dhënia e pasurisë së paluajtshme me qira dëshmohet me kontratë qiraje.

Llogaria në bankën e huaj mbi këtë bazë mund të çelet vetëm në vendin ku është blerë pasuria e paluajtshme që është objekt i kontratës së qirasë dhe mund të përdoret vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë deri në shumën e qirasë, të përcaktuar me kontratë qiraje.

2.11 Rezidentët që kanë fituar pasuri të paluajtshme jashtë vendit, për pagesën e shpenzimeve të pasurisë së paluajtshme jashtë vendit.

Fitimi i pasurisë së paluajtshme jashtë vendit vërtetohet me dëshmi të kryerjes së regjistrimit në regjistrin e investimeve në pasuri të paluajtshme në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shpenzimet e pasurisë së paluajtshme jashtë vendit dëshmohen me dokument të duhur nga i cili buron detyrimi për pagesën e tyre.

Llogaria në bankën e huaj mund të çelet mbi këtë bazë dhe vetëm në vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme dhe mund të përdoret vetëm për transferimin e mjeteve jashtë vendit, deri në lartësinë e shpenzimeve.

2.12 Rezidentët që zotërojnë letra me vlerë jashtë vendit, për shlyerjen e kërkesave në bazë të shitjes së letrave me vlerë jashtë vendit, dividendët, interesat ose normat e tjera të kthimit në bazë të letrave me vlerë.

Shitja e letrave me vlerë dëshmohet me një urdhërshitje/raport nga shitja e letrave me vlerë jashtë vendit, marrëveshje që rregullon marrëdhëniet me pjesëmarrësin e autorizuar të tregut të letrave me vlerë ose pjesëmarrësin e autorizuar të një burse të huaj ose të një tregu të organizuar letrash me vlerë ose dokument tjetër që mund të konfirmojë transaksionin. Kërkesat në bazë të dividendit, interesave ose normave të tjera të kthimit në bazë të letrave me vlerë dëshmojnë me një njoftim/dokument për pagesën e dividendit, interesit ose normave të tjera të kthimit nga letrat me vlerë, si dhe me ekstrakt nga llogaria e letrave me vlerë që lëshohet nga një depozitues i huaj përkatës.

Në urdhrin për hyrjet e ardhura, duhet të shënohet qartë baza e transaksionit (shitja e letrave me vlerë, pagesa e dividendit, interesit ose të ardhura të tjera).

Llogaria në bankën e huaj mund të shfrytëzohet mbi këtë bazë dhe vetëm për transferimin e mjeteve nga jashtë deri në lartësinë e shumës së kërkesës në bazë të shitjes së letrave me vlerë jashtë vendit, dividendët, interesat ose normave të tjera të kthimit në bazë të letrave me vlerë."

2. Në pikën 3, paragrafi 1 ndryshohet siç vijon: "Rezidenti mund t'i transferojë mjetet nga llogaria e çelur në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe pas skadimit të vlefshmërisë së dokumentit në bazë të të cilit është çelur llogaria".

3. Në pikën 5, paragrafi 2, nënparagrafët 6, 7 dhe 8 fshihen, ndërsa nënparagrafët 9 dhe 10 bëhen nënparagrafët 6 dhe 7.

4. Në pikën 7, nënpikat 7.6, 7.7 dhe 7.8 fshihen, ndërsa nënpikat 7.9 dhe 7.10 bëhen nënpikat 7.6 dhe 7.7.

5. Në pikën 10, nënpikat 10.6, 10.7 dhe 10.8 fshihen, ndërsa nënpikat 10.9 dhe 10.10 bëhen nënpikat 10.6 dhe 10.7.

6. Në tërë tekstin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16) fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut", me përjashtim të pikave 13, 14, 15 dhe 16 të Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16).

7. Lejet e lëshuara nga Banka Popullore në bazë të Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16) mbeten të vlefshme deri në afatin për të cilin janë lëshuar.

8. Në procedurat e filluara para hyrjes në fuqinë e këtij vendimi do të zbatohen rregullat sipas Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16).

9. Kjo vendim është në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Veriut të Maqedonisë.

O nr. 02-15/II-3/2019
28 shkurt 2019
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
E Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska